

VENDIM
Nr.476, datë 12.7.2006

**PËR MBULIMIN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA, PËR SHPENZIMET E
TRANSPORTIT TË MËSUESVE DHE TË NXËNËSVE, TË TRASHËGUARA
NGA VITI 2003**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të mbulojë detyrimet e prapambetura, për transportin e mësuesve dhe të nxënësve, të trashëguara nga viti 2003, përkatësisht, për zyrën arsimore, Kavajë, në shumën 2 000 000 (dy milionë) lekë, dhe për drejtorinë arsimore rajonale të qarkut të Tiranës, në shumën 700 000 (shtatëqind mijë) lekë.

2. Fondi prej 2 700 000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekësh të përballohet nga fondet buxhetore të vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha